# DËSHMI ARKIVI

**A-470189**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Rama zhgënjen Kosovën, asnjë fjalë për UÇK-në në fjalimin para OKB-së |
| ADRESA | `https://piranjat.al/kosova/rama-zhgenjen-kosoven-asnje-fjale-per-uk-ne-ne-fjalimin-para-okb-se-i106119` |
| BURIMI | piranjat.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 25 shtator 2026, 20:00:43 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 25 shtator 2026, 19:57:06 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `0458d7950727c0b3f0cf0c54a5138f2ad5c696cf0dcd47176fd1ec3c9fd57beb` |
| TEKSTI | `82d40c6245b7ad752ac59b3cc8dd3fdd8213b182cd4d2371d69f62aff0cde17f` |
| PAMJA | `d118c9bfb5a95eeea7356d456601c06ae01c2dddd07ddbe19c0faf61231a4351` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `5daf9023315a0cb1316984c1a977666ffc132fbea4501befb044e35bf3bb9f5d` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `f25232b47d2959dc6146897981a0af4e37060d45058c64d9459ab0f54fd17f54` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/5daf9023315a0cb1316984c1a977666ffc132fbea4501befb044e35bf3bb9f5d`

**PAMJA E FAQES**

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

KOSOVA

# Rama zhgënjen Kosovën, asnjë fjalë për UÇK-në në fjalimin para OKB-së

Piranjat Përditësimi i fundit 25 Shtator 2026, 21:57



Në Kosovë kishte një pritshëmri të lartë se Kryeministri i Shqipërisë Edi Rama do t'i kushtonte hapësirë në fjalimin e tij para Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së asaj që ndodhi me vendimin e Gjykatës Speciale të Hagës për ish-krerët e UÇK-së.

Mediat kryesore të Prishtinës kishin sot tituj si ky i Klan Kosova: "Rama mban sot fjalim në AP të OKB-së: A do të flasë për UÇK-në?".

"Me kërshëri pritet nëse në fjalën e tij kryeministri do të përfshijë edhe çështjen e liderëve të UÇK-së" – shkruan Telegrafi.

Por Rama i zhgënjeu të gjithë.

Fjala e tij 22-minutëshe nuk i përmbajti fare fjalët: "Kosovë", "UÇK" apo "Gjykatë Speciale". Shqetësimi më i madh i tij ishte Inteligjenca Artificiale dhe më pas "Revolucioni i Flamingove".

Kjo ka shkaktuar menjëherë reagimin e mediave të Kosovës.

"Kosova pa zë në OKB, Rama flet për inteligjencën artificiale" është titulli i Koha.net.

"Në asnjë rast të vetëm Kosova nuk është përmendur në fjalimin e kryeministrit të Shqipërisë, Edi Rama, në Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara të premten. Për rreth 20 minuta Rama ka folur për inteligjencën artificiale, rreziqet nga ajo dhe ka bërë thirrje për marrëveshje ndërkombëtare për "AI sovrane dhe demokratike" – thuhet në shkrim.

"Edi Rama nuk e përmendi në OKB dënimin e drejtuesve të UÇK-së" – e titullon shkrimin e saj "Kosovapress".

"Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, nuk e ka përmendur fare dënimin ndaj ish-krerëve të UCK-së në fjalën e tij në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së. Fjala e Ramës në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së u përqendrua tek inteligjenca artificiale, ku e përmendi edhe ''ministren Diella'', por jo edhe dënimin ndaj krerëve të UÇK-së" – thuhet në shkrim.

Edhe media tjetër e Kosovës, "Bota Sot" i mëshon faktit se "Edi Rama nuk e përmendi në OKB dënimin e drejtuesve të UÇK-së". Sipas saj Rama e kishte quajtur "marre" dënimin, por fjalën në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së e përqendroi "te inteligjenca artificiale, ku e përmendi edhe ''ministren Diella'', por jo edhe dënimin ndaj krerëve të UÇK-së".

Në një aktivitet të mëhershëm Rama akuzoi Joe Biden dhe SHBA-të se e tradhtuan Hashim Thaçin. Në fund ishte dhe vetë ai që e braktisi "komandantin" duke mos e përmendur në një nga aulat më të rëndësishme të botës. /Lapsi/

## Artikuj te sugjeruar

KOSOVA 25 Shtator20:05

**[Presidenti/ Hamza: Do i përshtatim qëndrimet pasi jemi në rrethana të reja, i gatshëm për takime]**

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Bedri Hamza ka thënë se vendi është në rrethana të reja, që nuk ka ...

KOSOVA 25 Shtator18:26

KOSOVA 25 Shtator18:20

[Protestë në Mitrovicë kundër aktgjykimit për ish-krerët e UÇK-së: Të gjithë për një dhe një për të gjithë për çlirimtarët]

Edhe në Mitrovicë mbahet protesta kundër aktgjykimit dënues të Gjykatës Speciale ndaj drejtuesve të UÇK-së dhe n&...

KOSOVA 25 Shtator17:23

[Kurti: Nëse nuk zgjidhet presidenti, vendi shkon në zgjedhje të reja]

Kryeministri Albin Kurti ka deklaruar se nëse Kuvendi nuk arrin ta zgjedhë presidentin e ri të Kosovës, vendi mund të shkojë n&eum...

KOSOVA 25 Shtator15:32

[Mali i Zi ndalon ngarkesën me mish të skaduar të destinuar për Kosovën]

Dogana e Malit të Zi njoftoi më 25 shtator se ka ndaluar në Portin e Tivarit një kontejner me mish të ngrirë gjedhi me afat t&eu...

KOSOVA 25 Shtator14:27

[Ambasada amerikane: Presim të punojmë me Qeverinë dhe Kuvendin e ri të Kosovës për prioritetet e përbashkëta]

Ambasada amerikane në Prishtinë ka deklaruar se pret që të punojë me Qeverinë dhe Kuvendin e ri të Kosovës për t&...

KOSOVA 25 Shtator13:10

[Kapet një kontejner me 24 tonë mish të skaduar, ishte i destinuar për "Apetit" në Kosovë]

"Zyrtarët e Administratës Doganore më 24 shtator 2026 kanë kontrolluar një kontejner me mish viçi të ngrirë, i...

KOSOVA 25 Shtator12:56

[Çfarë strategjie mund ta ndjekë Qeveria e Kosovës për apelin në Hagë?]

Tetë ditë nga dënimi me burgim të përgjithshëm prej 81 vjetësh i katër ish-krerëve të Ushtrisë Ç...

KOSOVA 24 Shtator21:13

[Për të nëntën natë, qytetarët protestojnë kundër aktgjykimit të Speciales]

Qytetarë të shumtë janë mbledhur sërish të enjten mbrëma në sheshin "Skënderbeu" në Prishtinë...

KOSOVA 24 Shtator21:01

[EMRI/ Shqiptari pranon fajësinë në SHBA për krime kibernetike, drejtoi platformën Rydox]

Ardit Kutleshi, 28-vjeçar nga Kosova, është deklaruar fajtor në Shtetet e Bashkuara për akuzat që lidhen me krijimin dhe funksio...

KOSOVA 24 Shtator19:05

[Eurodeputeti kroat: Pa normalizim me Kosovën, Serbia s'ecën drejt BE-së. Merkel fajtore]

Eurodeputeti kroat nga radhët e partisë HDZ, Davor Ivo Stier, ka deklaruar në emisionin "Romano Bolkoviq – 1 na 1" në televizionin kro...

## ME TE VIZITUARAT

AKTUALITET 25 Shtator

["Më quajti lopë kur isha shtatzënë"/ Pas videos...]

Një situatë e paprecedentë raportohet të ketë ndodhur një muaj më parë në qytetin e Durrësit, ku shefi i Kom...

AKTUALITET 24 Shtator

[Sherr mes Lalës dhe Rexhajt: Meriton të rrihesh...]

Një përplasje e ashpër ka ndodhur në studion e "Opinion" mes analistit Albatros Rexhaj dhe gazetares Klodiana Lala. Debati u nd...

AKTUALITET 24 Shtator

[Prova që fundosi shefin e Policisë Shkencore, d...]

Një akt-ekspertimi për makinën "Land Rover Defender", i kryer me kërkesë të SPAK nga Policia Shkencore, ka mbërrit...

INVESTIGIME 25 Shtator21:35

[Nga tritoli te kërcënimet me jetë/ Çfarë po ndodh me policin Altin Preka?]

Altin Preka, efektiv i Policisë së Shkodrës, rrëfen për “Piranjat” historinë e përplasjeve të tij me epror&e...

## video



## Institucionet në shërbim të krimit: Pse hesht kryeministri për skandalet?





**Institucionet në shërbim të krimit: Pse hesht kryeministri për skandalet?**



**Nga tritoli te kërcënimet me jetë: Çfarë po ndodh me policin Altin Preka?**



**Porti i Durrësit po mbyllet, investimet në infrastrukturë vazhdojnë. Cili është justifikimi i APD?**




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.